Pasi një mashkull apo një femër që mund të ketë pranuar imponime, fillojnë akuzat ndaj njëritjetrit se çfarë po u ndodhë, siç mund të shkojnë në trishtim familjarë si:

- përçarje familjare, largim nga njëri tjetri.
- konflikt fizik, ushtrim i dhunës.
- ndarje në çift.
- fëmijë jetim – përgjegjësi e kujtë.
- konflikt familjar, miqësor.

Sa e sa herë krijohen në familje konflikte dhune kur femrës apo mashkullit i

ngritet “forca artificiale e përkohshme” e cila nuk është në gjendje të veproj si duhet nëse verëhet nga anëtarët tjer të familjës, që shkonë në komplekse psikologjike te ata përsone që janë afër fizikisht, sidomos në moshë të shtyer, u ngritet spontanisht. Nëse cilido qift i ka parasyshtë këtë ego, këtë mendim negativ, këtë veprim negativ, shumë lehtë i tejkalonj gjerat. Ky çift, kjo familje e lumtur shumë mir mund të kontribuoj në kulturë nacionale dhe të njëjtën ta mbajnë në familje.

Ky problem njerzor botëror ka qenë është dhe vështirë se do të largohet nga njeri nga sistemi i njeriut, nga sistemi i universit.

Suksesi i çiftit në martesë

Suksesi i një çifti martesor, që nga ditet e fillimit të krijimit te bindjes se dy te ri janë për njeri tjetrin dhe vendosin të kenë familje. Krijohet bindja nga gjendja e brendshme e tyre për cilindo qëllim jetsorë, se e kalojnë me besnikerin apo kulturën me te lartë të popullit të tyre. Bindja se janë një qiftë i rrallë dhe me vision përparimtarë.

Por një gjë gjatë jete te shumë qifte është ende e pa diskutuar në mesin e familjës si qëllim pozitiv apo qëllim që buron ndjenja negative për njeri tjetrin gjendja jetsësore dhe gjendja nga brendësia e tyre.

Të gjitha gjërat dhe dukurit të cilat një qiftë prindërisht i aplikojnë gjatë jete, i shofin si gjëra pozitive dhe negative. Te cilat kryejnë mbi bazën e detyrimit dhe punëve të secilit përsone në familje. Këto gjëra në shumë raste gjatë jete kalojnë nga raportet pozitive në pakujdesia negative.

Nëse i kalkulon disa gjera nga gjendja e brendshme e njeriut. Atëhere një qiftë prindërisht shumë here gjatë jete kalojnë në paknaqësi nga pakujdesia e tyre dhe nga mos informimi me kohë për gjendjen e brendshme të njeriut si masë negative për qëllim të ndryshme gjatë jete. Këto qëllime nuk janë asgjë tjetër përveç një "këmbëngulje psikologjike" duke mos pranuar shumë gjera si realitet kohe apo realitet zakoni.

Kjo këmbëngulje psikologjike, e cila shfaqet te disa persona mashkuj dhe femra për qëllime të ndryshme nga mos njohja e gjendjes së brendshme, atëhere fillon edhe konflikti martesor për raportet të ndryshme.

Bindja e cilitdo njeri mashkull dhe femër, që nga koha e rinisë, se vetë familjës së tyre mund t'i shkaktojnë probleme në martesë. Nga gjendja e këmbëngulje psikologjike, mendjes së kufizuar, e cila shfaqet kohë pas kohe të qiftit në martesë. Cilido qiftë prindërisht e kalon shumë mirë apo për mrekulli kur të njohin këtë fenomen që nga krijimi i njeriut.

Si ti ruajm fëmijët nga e padëshiruara

I lindur me të drejta të shëndosha, të drejta natyrore, duke mos ditur se çka është diskriminimi, dhuna, pakujdesia. Shëndeti i fëmijës është një ndër çështjet më kryesor të familjës dhe shoqërisë, fëmiju në vitet e rinisë nuk është i vetëdijshëm për shumë çështje që e rrethojnë në përditshmërinë e aktiviteteve, si koha e lirë, lojrat, infrastruktura, egoja emocionale, egoja për tu knaqur.

Aventurat për të dalë në ambiente jo të njohura, mendimi i detyruar me forcë, vlersim i shpejt, disa nga efektet që e preokupojnë një fëmijë i cili nuk i ka të spjeguar si duhet në familje, në shkollë.

Pasojat e ndëshkimit trupor të fëmijëve rrjedhin nga prindërit dhe mos trajtimi i ktyre gjerave në familje, si pasoj shumë fëmijë e pësojnë nga rrethanat biologjike dhe post traumatike nga rrethanat e ndryshme jetësore, gjdo gjë që është e lidhur me pasojën e dëmtimit trupor ka të bejë me "egon emocionale" për të cilën fëmijët në të gjithë botën kanë para vetës shumë pakë njohuri.

Dëmtimet trupor të fëmijëve lënë shumë gjera negative pas familje, nga këto ndëshkime fëmijët ndihen të pa barabart në shoqëri, duke e fajtuar vetvetën se si ishin të pa kujdesshëm në vendin që e pësuan. Pasojat me të vrazhda mund të jenë largimi nga jeta normale e një fëmije, mos konsumimi i gjerave elementare familjare, mos ndjenja i të qenit i barabartë në mesin e shokëve.

Një ndër faktoret më të rëndësishëm për ta pasur parasyshë prindërit është "egoja emocionale" dhe "urdhëri hipnotik" dy forma që u vlen si mendim i detyruar me forcë për shumë çështje apo veprim që i shfaqën fëmijës për të, vepruar, folur, ngacmuar, fyer, goditur, lozur, për të tërhequr mjete të lëvizëshme, për të hipur në objekte të larta, për të ngarë biçikletën, për të dalë në ambiente jo të njohura për fëmijën.

Fëmijët në shumë raste e pësojnë dëmtime trupore nga pakujdesia njerzore, nga transporti publik dhe privat, nga ai që e quajmë "faktori njeri" ku është i atakuar drejtpërdrejt moshë madhore me urdhër hipnotikë. Të gjitha rrethanat tjera janë të mundshme nga aktiviteti ditor i fëmijës dhe memorja mendore për të vlerësuar atë aktivitet. Për këtë gjë fëmijët duhet obliguar që të kenë njohuri sa më të shumta sidomos që nga fjala e liru me sugjestion, që nga

veprimet negative të shokëve, veprime që lirohen papritur nga egoja për të folur për të vepruar, për të përfituar diç, dhe nga pakujdesia e vlersimit në ambientin dhe rrethanat që gjendet njeriu.

Fëmijet shpesh eskalojnë në shtytje të dhunës apo përleshjet ndërmjet vetës dhe shokëve të tyre, shpeshherë vlersojnë punë të arritshme të cilat nuk mund ti arrijnë. Si dëshirë e fëmijëve për punë në aspektin financiar, që është një atribut së fëmijet, detyrohën të punojnë, nga kjo punë pësojnë dëmtime trupore. Mungesa financiar e prindërve për fëmijë, dhe fëmijët e kategorive të ndryshme dalin nga rregullat njerzore normale, nga mos konsumimi i gjerave elementare familjara me kohë.

Kujdesi më i avancuar dhe më i lehtë i prindërve dhe fëmijëve është një ndër rekomandimet me të rëndësishme që të kenë parasyshë “egon emocionale” dhe “urdhërin hipnotikë” që e pësojnë fëmijët gjatë jete. Ndër kontribuesit me të mdhenjë të parandalimit të dëmtimit truporë të fëmijëve është autoriteti i sigurisë, apo grupet e posaçme të autoriteteve të siguris së shtetit dhe ekipet që merrën me çështjen e “urdhërave hipnotik”.

Një nga elementet me negative të ndryshimit të mendjës së fëmijës për të vepruar, ky urdhër hipnotik vie në mendjen e fëmijës nga faktorët e ndryshëm, sidomos faktori njëri. Në këtë fushë mund të kontribuojnë edhe psikologët, qytetar të ndryshëm që merrën me meditime pozitive, në largimin e enërgjive negative nga mendja e fëmijëve dhe lirimin e energjive pozitive për jetë.

Njëkohsisht mund të kontribuojnë edhe ekipet që mund të formohën në shkolla, fshatra, lagje, qytete, ekipe që punojn në

aspektin psikologjik pozitiv. Shoqëria e shëndoshë me informata rreth fenomenit njeri është ajo shoqëri e cila i trajton fëmijët që nga mendja, veprimet, gjestet, sjelljet, aktiviteti, mbajtja me informacione të kohës, koha e caktuar në teknologji, mundësia e shfrytëzimit të gjerave elementare të domosdoshme si garderoba, pushimet e vikendeve, vizitat e vendeve me rëndësi të veqanët trashëgimore, kulturore, historike, parqet, pushimoret, si dhe pushimet verore dhe dimrore. Koha e organizuar gjatë dite, jave, muajt, vitit, me një ritëm të shkollimit dhe benifiteve të shendosha për jetën e fëmijëve deri në moshën madhore.

Puna më e mirë me fëmijët është trajtimi në aspektin psikologjik gjatë moshës së rinis deri në moshën madhore, në mënyrë shumë të intensifikuar gjatë shkollimit, si lëndë e posaçme që nga klasa e parë deri në përfundimin e shkollës së mesme. Duke i sprovuar edhe me teste të veqanta kohë pasë kohe, që të kenë njohuri rrethë egos emocionale për të vepruar me kujdes të shtuar. Njohurit e familjeve me këto gjera kontribuojnë në ngritjen e kulturës nacionale të shoqërisë së avancuar bashkëkohore, fëmijët domosdoshmërisht përfitojnë kushte me të favorshme për jetë dhe anashkalimin e demtimeve trupore. Suksesi është në duart e fëmijëve me një përkujdesje të shtuar gjatë mësimi të gjitha ketyre gjerave të lartcekura.

Raporti i prindit ndaj fëmijës gjithnjë duhet të mbahet në përkëdhelje, prindi në vazhdimësi gjatë jete në forma të ndryshme duhet që ta përkëdhelë fëmiun e vetë. Si babai si nëna raporti me fëmijë duhet të mbahet kulturor me një kujdes te veçantë deri në moshë madhore të pjekur. Atëhere fëmiu mbanë kujdesin e shtuar ndaj prindërve se si është trajtuar si fëmijë gjatë adoleshencës.

Fëmijëve kur u krijohet bindje pozitive kulturore gjatë jete gjithnjë reflektojnë pozitiv. Përkëdhelja krijojnë bindje harmonie që nga fjala pozitive deri të ledhatimi dhe mundësia e shpeshtë që fëmiju të përdorë gjëra të ndryshme që nga gjësendët, veshjet, pushimet, koha e lirë me aktivitete. Si bindje, se fëmijët reflektojnë jetë pozitive për të ardhmen e ndritur në vazhdimësi, kjo dukuri e veqanëta e trajtimit mundeson kultur të ngritur familjare.

Cilado punë e ndryshme që e punon një person mashkull apo një femër, dhe për këtë punë japin kontributin e mjaftushëm, nga gjendja e brendshme e njeriut, shpërblehen, me diçka pozitive në të ardhmen. Ky shpërblim mund të paraqitet në çfarëdo pune që marrin apo kryejn si individ apo si qift, si në aspektin e fëmijëve, familjes, dhe veprime tjera që kanë të bëjnë me zhvillimin e familjes.

Puna cilësore dhe komtributi sa më i madhë për atë punë vë në shpërblim i bindjes së njeriut nga vetë bindja e tij shpirtërore njerzore, se duhet arritur edhe me shumë. Sidomos kujdesin e veçantë me përpjekje maksimale se një punë brenda kohës së caktuar komtributi duhet të bëhet i cilësis dhe mundit të mirë.

Kur një punë kryhet mirë vetë njeriut i ecën puna me mirë në të ardhmen, për cilindo veprim që kryen gjatë dite, gjatë jave, gjatë muajt, gjatë viti.

Trungu kulturor kombëtarë

Trungu kulturore kombëtare, është bindje shpirtërore kulturore kombëtare, rregulla që burojnë nga gjendja e brendshme e njeriut. Si bindje besimi natyrore krijues se populli ka gjuhë, kultur, gjak të njëjtë prej së është krijuar e folmja e gjuhës së nënës. Bindje shpirtërore kombëtare me kultur nacionale të njëjtë, që identifikohen qytetaret e përkatësis etnik.

Vetëkultura

Vetë besimi

Vetë deklarimi

Trungu është epi më i lartë dhe i veçantë në mesin e një civilizimi kombëtare, një zhvillimi të kulturës nacionale të një populli. Familja është baza e njeriut dhe fuqia hyjnore, brez pas brezi në familje që mbisundon paqja kulturore dhe edukata familjare kulturore, zakoni avancohet brez pas brezi. Ky avancim mbetet si rezultatet e aplikimit të gjërave me të avancuara në kohë me një kujdes të veçantë.

Si, njeriu mashkull apo femer nga vetëkultura, duke zërbërthyer se çka është pozitive dhe negative nga vetë personi. Por kjo vetë kultur po fokusohet nga zgjedhja, në dukje, zgjedhja në komunikim, zgjedhja në veshje, zgjedhja e deklarimit për tema të ndryshme, duke u larguar nga disa gjëra të pastra zakonore të kohës.

Për secilën çështje njeriut që i ofrohet informacioni, modeli i veshjes, menyra e shfrytëzimit të gjërave, pavaresisht disa gjëra nga jeta që nuk janë pozitive për çdo vend apo familje, ato gjëra i zgjedh një pjesë e

shoqëris, disa lavderohen disa qeshen me ato gjera qe i perdor nje pjes e shoqëris.

Bindja se trangu është vetë populli me gjuhën, zakonet e zhvilluar gjeneratë pas gjenerate, prind – djale, vajzë, nënë – djalë, vajzë, vëllezër e motra.

Kur të rinjtë të aplikojn cilëndo veshje, pije, në bazë të vendit, duke vlerësuar vendin se çfarë është ceremonia se çfarë moshash janë prezente, kultura familjare mbisundon gjithnjë.

Cilado moshë nuk është e gatshme të përballoj çfarëdo veshje, çfarë do pije, në cilendo ahenge, festë, ceremoni. Të gjitha këto elemente kanë rëndësin e veqanët, vendi u mundeson të mburren me atë që kanë praktikuar dhe aplikuar si kulturë e avancuar familjare.

Çështja familjare diskutohet në familje si çështje që kanë të bëjnë vetëm me gjenerata konkrete që janë traditë gjeneratë pas gjenerate. Të cilat janë burim i qëllimit të vertetë.

Duke hulumtuar një numër të konsiderueshem popujsh për kulturë kombëne e tyre, nga se çfarë pozicioni mbajnë në raport me shoqëritë tjera ose popuj tjerë. Vetë qenia e popullit, vetë raporti kulturorë në raport me zhvillimin e familjes. është baza me e veqanët e trangu kulturorë kombëtarë. Zakoni i avancuar me kohë, duke përshtatë me trendin pozitiv të moralshëm me kohën është pasuria me e çmuar e një familje.

Fuqia e kulturës familjare është vetë deklarimi për çdo gjë të avancuar në nivel nacional të vendit. Përgjegjësia e lartë dhe e

ndritur e një familje është mbajtja e një tradite të kohës gjeneratë pas gjenerate.

Një nga mundësit e një individi, një familje, se si mbahet kultura familjare, si ngritet, si avancohet, si praktikohet, biondja se sëvetetës në mundësinë se faktori njeri.

Mbështetët më me shumë gjërpozitive gjatë jete se sa në gjëra negative, por ato gjëra negative të cilat e dëmtojnë imazhin familje, vien nga pakujdesia familjare, nga mosbindja, nga informacioni paraprak i devijuar për mundësit pozitive dhe negative të njeriut.

Gjithnjë është thënë një fjalë e mirë, ndryshon botën, një krijim bindje për të larguar nga cilado gjë negative është pasuri e çmuar familjare. Thesari më i çmuar në jetë është ruajtja e familjes gjeneratë pas gjenerate, bindja pozitive në familje mbanë peshë të madhe deri të largimi i cilitdo mendim negativë.

Dilaogë gjenerate

Dialogë ndërmjet dy të rinjëve në moshë të njejtë, se si e shohin trendin dhe qasjen e jetës, çka u ofron koha.

Ajfol dhe **Albeniti**, bisedojn për jetën e pasur të ngritur si protagonist të dy familjeve me kulturë kombëtare, si të qytetruar në kohë.

Ajfol dhe Albeniti

Diskutim për suksese familjare

Përmiresimi i kulturës familjare ndërmjet kohës dhe zakoneve që aplikojn si qytetarë të cilët mundohem të mbajnë kulturë familjare. Me vlera të larta nacionale te

vendit, duke mos lënë anash trendet që ofron kultura rajonale dhe ndërkombëtare.

Qasje e ketyre dy të rive ofron komunikim kulturorë të avancuara. Së pari nga lira e komunikimit:

Ajfolat:

E konceptuar dhe përqendruar në mbështetjen e prindërve, që të aplikojn jetën e përditshme duke u përshtatur avancimit të kohës.

Njeriu i cili aplikon çdo gjë në jetë duke vlerësuar vendin në të cilin gjindësh, ambientin, rëndësin e ceremonisë, rëndësin e aktivitetit, moshat e njerëzve, kulturën e nacionalitetit. Duke filluar që nga veshja, rëndësia e veshjes e cila duhet të përdoret sipas vendit dhe rëndësisë.

Albeniti:

Mban qëndrimet e rishikuara të kohës, në formën qytetare që ofronë ambienti, qasje, kulturë nacionale, një njeri mashkull apo femër sipas moshe dhe vendi duhet të mbajë dukjen dhe veshjen e rëndësishme sipas vendit dhe ceremonisë. Veshja serioze në vendet serioze, veshja e zakonore për çështje kulturore, veshja tradicionale në vendet dhe aktivitete tradicionale, veshja e rëndësisë së veqanët në ambientet e rëndësisë së veqanëta, parku, sheshi, shetëtorja veshjen normale dhe jo provokative nga asnjëra gjini.

Ajfolat:

Është e mendimit të Albenitit, për një kulturë familjare duke filluar që nga vendosja e emrit të fëmijës nga kultura e pastër e gjuhës

së nënës. Dhe në cilindo ambient të rezultoj kultura normale e praktikimit të komunikimit në ambientet të ndryshme, në lirin e komunikimit shoqërore.

Ndërgjegjia, të rinjë të vende të caktuara si shetëtorë, shesh, ambient serioze i nxitë nëse përdoren veshje provokative, të cilat përdoren apo vishen nga tërheqja emocionale e përkohshme e cila vë për momentin si dëshirë e vetë njeriut, ajo veshje provokuese e cila në ambiente serioze nxit persona të caktuar të cilët mundohen të mbajnë kulturë familjare

Albeniti:

Ndërgjegjia e njeriut, në raste të caktuara apo ambiente të caktuara lejon çdo gjë që një njeri mashkull apo femër të përdoren, por masës se përgjithshme nuk i përshtatët.

Ndërgjegjia e njeriut, cakton edhe vendin ku një njeri mund të shfrytëzojë cilëndo dëshirë, pishina, plazhi pranë detit apo në vende të ndryshme është një veqori e kërkesës së veqanët, e cila mund të kalojë gjërat pozitive dhe të padëshiruarat njerzore, në mbajtjen e faktorit njeri.

Ajfolat:

Kjo gjë e bindjes time është e rëndësishme se njeriu është për t'u diskutuar ndërmjet gjenaratave të reja si pjesë e kulturës familjare. Rinia është e fokusuar në besimin krijues, e cila është bindja më e fuqishme e shoqëris bashkëkohore.

Albeniti:

Koha e krijonë mundësin në të gjitha rastet e një veprimi të një të riu, kjo form e vetëdijës njerzore mbanë në kulturë të gjitha familjet.

Ajfolat:

Ndryshimet e kohës sipas mendimit timë, do duhej praktikuar me rrethana të veçanëta të komunikimit kulturorë. Një dukuri e mbështetjes së gjeneratave në të ardhmen me mundësi të qasjes në profesion të mundëshem në zhvillim të pandashëm. Cilado familje gjenë vetën me mundësi me të mira të punës dha mbajtjen e kulturës familjare.

Albeniti:

Përcepton mundësin njerzore si primare për të ndryshuar qasjen në veprimë pozitivë, gjeneratë pas gjenerate, prind - fëmijë. E vetmja mundësi e ngritjes, mbajtjes së kulturës së lartë familjare, si vlerë kulturore kombëtare.

Ajfolat dhe Albeniti:

Bashkëmendojnë, bashkëveprojnë, bashkëpunojnë, gjithnjë bashkëbisedojnë, bashkërrefejnë, se njeriu është qenie fleksibile dhe cilido qytetarë do duhej të bëhet zëri i lartë i familjes në parandalimin e dularive negative dhe dergimin e fjalës pozitive të secila familje, dhe të ato familje ku vështirë se mundë të arrijë, shkoj fjala e parandalimit të vetive dhe dukurive negative.

Bisedë e shokëve

Një grupe shokëve që merren me tretman, meditimi dhe hipnozë.

Bisedojn për temen: Si duhet prinderit të përgatiten që nga koha e shtatzanë së, një nënë përveqë që duhet të ketë informim të pasur rreth faktorit njeri, dhe krijimit të bindjes se që nga koha në _3_ tre muajshin e shtatëzanisë, është e nevojshme të krijo një bindje se vetë prindërit janë faktor i suksesit të fëmijës. I cili lind në rregull dhe normal, gjatë kësaj kohe nëna përveqë një detyrë që mund ta ketë në shtëpi të lehtë dhe me obligimet më shumë rrethë fëmijës. Një mendje të pastër dhe të kthejëllët me obligime shumë të vogla deri në kohën e pas lindjes, si qëllim se po sjell në jetë një fëmijë të shëndosh dhe normal. I cili lind me suksese të caktuara jetsore, për jetën e ti.

Gjendja e njeriut, pjesa pozitive prodhon lloj lloj dëshirash të cilat aplikohen nga një pjesë e qytetarëve. Keto gjëra jetsore, mund të jen konsumuese, shfrenuese, prodhuese veshjesh, avanturiste, ngurruese dhe të ndryshme.

Këto gjëra nuk mund të pranoj shoqëri menjëherë, gjithnjë çdo trend i ri për qytetar i ofrohet një "tridhjetë" përqindeshi i një përdorimi për kohë të caktuar. Forma e përzgjedhjes vie si dëshirë e bindjes nga pamja ose reklama, si bindje tërheqëse e imponuar nga rrethanat e ndryshe se trendi është i kohës dhe më i miri.

Nuk është idea më e mira në cilendo kohë qytetari të mundohet të aplikoj menjëherë çfarëdo që i ofrohet nga cilido treg apo medium. Këtyre gjërave u del modeli shumë shpejt gjithnjë ofrohen forma

dhe produktet që i mbijetojnë kohës, asgjë negative nuk i mbijeton kohës.

Qytetari me vigjilencën e ti duhet përpjekur që sa më pastër dhe sa më kulturore, të aplikoj cilëndo gjë jetsore gjatë jete, një nga format që i reziston kohës. Trendi sidomos në veshje ofron modele të ndryshme që mund të duken disi të kohës, por në të vërtetën trendi për kulturën e pastër të popullit nuk ofron asgjë të re vetëm demode të përkohshme e cila mund ti kalojë koha shumë shpejt. Trendi për shumicën e qytetarëve s'është asgjë tjetër vetëm dukje e cila pas disa kohësh nuk i pelqen as vetë ato personi mashkull apo femër që ka përdor apo aplikuar përkohësisht.

Qytetari si medium dhe marrës i ideve, prodhuës i ideve, prodhuës i trendit të përkohshëm, konsumuës i gjësendeve të ndryshme, nuk e arrinë si duhet të konsumojë atë gjë të trendit, në kohë të caktuar, nga obligimet familjare mundësin e largon për kohë të caktuar që të konsumojë sipas mundësie dhe kohe. Faktori jetë, mundëson që ajo gjë që ofrohet në mënyrë të pazakont, me vigjilencën e tyre qytetare, do duhej të krijojë mbështetje të punës që t'i arrijë cilindo gjësendë apo trend të kohës, në formën dhe mënyrën mesatare kulturore.

Gjëja më e mirë është për secilin moshë gjërat normale sipas vendi dhe kohës të konsumojn apo përdorin secilin brend të cilësdo çështje të jetës së njeriut. Njeriu në shumë raste mashtrohet me atë që shifët me sy dhe me atë që mund të ja arrijë.

Thënie për familjen

- Familja është krijes e çmuar e cila hyn në vlerat më të larta njerzore. Pjdestali më i lartë dhe më i çmuar mbetet ruajtja e familjës. Nga vetë anëtarët e familjës.

- Koha është e çmuar atëhere kur ka paqë, dashuri, respekt në familje nga gjendja e brendshme e njeriut që nga krijimi i njeriut.

- Besimi natyrore krijues, është ndërgjegjia më e pastër e fëmijës gjatë gjithë jete. Forma më e dëshiruar e jetës është krijimi se qenie humane rregullon sistemin me të mirë për t'u përballur me çdo sfidë.

- Karakteri dhe sfida në familje janë dy elemente më të rëndësishme për ngritjen mbajtjen e kulturës familjare, edukata familjare kulturore qensisht është suksesi. Karakteri identifikohet me kultur, sfida identifikohet me edukatë.

- Gjyshërit, gjithnjë tregojnë histori jete. Prindërit gjithnjë tregojnë rrugën e dëshiruar të suksesit. Fëmijët frymzojnë jetë dhe suksese nga kultura familjare e fituar me edukim.

- Fëmijët janë radha e parë e sëardhmës, rruga e dritës e përcaktuar nga fuqia e njeriut ndalohet me fëmijë, koha frymzon rrugë me fëmijë të zënë në familje dhe shkollë.

- Forca e suksesshme e familjës nuk paramendohet pa fëmijë, suksesi i pandalshëm arrihet vetëm me rini, e ardhmja ndryshon nga e vërteta “fëmijë në familje”.

Angazhimi i rinis

Angazhimi në kulturë familjare për vullnetarizëm, do të krijoj bindje te rinia. Njeriu është faktor suksesi gjatë jete, vetë njeriu duhet të merr iniciativa për rregullimin e infrastrukturës vullnetare.

Njeriu mbledhë suksese dhe i jeton, njeriu i largon gjërat negative.

Rinia është qenia e ndryshimit.

Rinia frymazon jetë.

Rinia nxit suksese.

Rinia është faktorë.

Sot me rregulla, disi të aplikueshme. Nesër me rregulla të reja civilizuëse. Nesër dhe në vitet në vijim vullnetarë të suksesit. Krijimin e bindjes për të organizuar punë vullnetare deri te arritja e qëllimit individual, dhe kolektiv pavaresisht gjinie dhe komuniteti. Njeriu mban sukseset dhe gjërat negative, nga zero të krijohet bindje organizative në punë vullnetare të ndryshimit pozitiv për lagje – fshat – qytetë.

Me atë rast kur rina e krijojnë bindjen se vetë është formula e arritshmëris, ja arrin të kontribuoj në vullnetarizem, pun vullnetare, organizimi vullnetare, ndryshim nga vullnetarizmi. Dërgon rinin në sukseset e dëshiruara drejt karrierës jetsore. Me atë rast kur fillon të krijoj bindje se vet i riu e reja jan ndryshim, me vullnetarizëm arrin ti eliminoj gjërat negative.

Idea e bindjes së: - aktiviteti vullnetare është pjesë e fillimit të ndryshimit. - puna vullnetare pjesë e një gjetje te vendit të punës. - vullnetarizmi kolektive, iniciativa e ndryshimin të qasjes ligjore për interesimin e te rijneve. -

kontrbuti vullnetare punë e vlefshme për shoqërin. - organizimi vjetore vullnetar, kulturë nacionale e vendit.

Angazhimi, i të rive do të bëhet në organizimin e tyre në shkollë. Në krijimin e përfaqësuesve të të rive. Për interesat e tyre. Për ndryshim qasje në përkrahje te rinis në të ardhmen.

Të riti do të organizojnë prindërit e tyre më krijimin e kushteve në lagje - fshat, për ndryshim dhe krijim të vendet e mundeshme ku te rit mund te krijojnë me profesioni e tyre zanatë pune.

Angazhimi do të organizohet në pjesmarrje të drejtpërdrejt të rinis gjat vitit për vullnetarizëm dhe të bëhet rregull vjetore. Prej kohës së lirë pas orëve mesimore.

Të rinjet do te marrin iniciativa, të drejtpërdrejt - me këshillin e shkollës, - këshillin e lagjës - fshatit, - institucionet lokale, drejtoratin e kulturës rinis dhe sportit.

Prindërit, do të organizohen në punë vullnetare në lagjë – fshat – qytetë, për krijimin e mundësisë për bashkëpunim me institucionet lokale. Në përkrahje të drejtpërdrejt në burime financiare në zanatë të të ritë, në lagjë – fshat – qytetë.

Të ritë, do te krijojnë grupet vullnetare bashkë me prinder, në lagjë – fshat – qytetë në komunikim me institucionet lokale. Për ndryshim qasje në burime financim në zanat pune.

Si mundesia e kryerjes së praktikës profesionale - përkrahja e hapjes së biznesit në lagjë – fshat – qytetë.

Gjat krijimit të grupeve të ritë do të

mbeshteten nga shoqata **MILNKUK KOSOVA**, me informacion rreth teme. Do t'u ofrohen fletëpalosje me informatat rreth temen rreth aktiviteti, mundesit e ndryshimit në vendimarrje, punë dhe vullnetarizëm të rregullt, në të ardhmen si mënyrë e aktivizimit të qytetarëve të organizuar.

Nën grupet e përfaqësimit të grupit do të jenë në kontakt të vazhdueshëm me zyrtaret e shoqatës rreth aktiviteti. Dhe te gjeturat në raport me këshillin e përfaqësimit kompetent.

Objektivi i projektit është arritja e qëllimeve të synuara nga zbatuesit në bashkëpunim me të ritë e Kosovës. Organizimi në grupe vullnetare është privilegj për të ndryshuar qasjen individuale në qasje kolektive të suksesshem, në mbështetje të familjeve.

Rendesia e projektit është i arsyshëm për të implementuar në praktikë, qytetarët gjithnjë kanë nevojë për mbështetje. Qytetarët pavaresisht komunitetit apo gjinisë kanë nevojë të arsyeshme e mendojnë temen, synimin e çartë, aktivitetin që u mundeson një punë e cila i organizon në veprim për të rregulluar diçka me mirë.

Praktika e vullnetarizmit është veprimi me i mirë dhe domosdoshëm për të arritur synimet qëllimin e favorshëm për qytetarë. Kultura familjare është bindja më sublime e një populli, bindja e vlerave të larta nacionale të vendit.

Projekti kulturë familjare është i rendesishëm në organizimin e rinisë në fuqizimin e nevojave të përditëshme në jetë. Ideja e vullnetarizmit e mbështetur mbi identifikimin e të rive apo grupeve të rinisë dhe qytetarëve. Në organizimin e sigurtë dhe

të mirfillt me synime pozitive për të ndryshuar nga neglizhenca ditore, në organizimin, s'i punë vullnetare dhe për bashkëvendimarrje në mes organizimit si këshill shkolle, këshill fshati, autoritetet të kuvendit komunal.

Si pikë fillestare do të krijojmë grupet e përfaqësimit, të cilët përfaqësojnë interesin kolektive të rrethit, dhe banimit ku jetojnë qytetarët, këshilli i shkollës, këshilli i fshatit.

Pjesëmarrje në konsultime në nivel lokal. Ofrimin e edukimit në sferën e njohurive financiare.

Krijimin e vendeve organizative në lagje – fshat – qytet s'i qëndër e vullnetarizmit të rregullt. Logjika e vlefshme për ngritjen dhe organizimin e vullnetarizmit të rinia përben një sfidë të organizimit të kohës.

Rinia duhet krijuar bindjen shpirtore se sukseset janë njerzore dhe si të tilla është e rendesishme të bëhet praktikë e angazhimit të rinisë.

Sukseset duhet me një punë të mirfillt vullnetare të praktikohen në mbështetje të komunitetit, në aplikimin e mundesive së dyfishtë për të organizuar aktivitet vullnetarë. Rinia e bindur së përveq rendesis së angazhimit në formë të drejtpërdrejtë është e vetmja mundësi e artitjes së qëllimit.

Rinia mund të peshon sukseset e veta ndërmjet kohës së lirë, dhe kohës së aktivitetit për punë vullnetare për arritjen e synimit të ndryshimit pozitiv për pjesëmarrje në ndryshim dhe vendimarrje kolektive të komunitetit shoqërorë.

Projekti është i arsyeshëm dhe i domosdoshëm në zbatim, nga aktiviteti do të nxjerrim raportet e pazbuluara për komunitetin në organizim. Të ritë e Kosovës janë shumë aktiv por u mungon një strategji përkrahëse për të marrë guximin e ndryshimit në praktikë. Të rive të Kosovës u mungon një bashkëpunorët i cili i mbështetë dhe merr inicitiva për rregullimin e infrastrukturës vullnetare.

Vullnetarizmi nxjerr bashkëpunorët për të ardhmen në një nga mundësitë e ndryshimit që ofrohet nga vullnetarizmi është të identifikimi i problemit që jetojmë. Me atë që duhet të jetojmë në të ardhmen, rinia e Kosovës duhet të kalkulon në atë që mos të llogaritet në atë që kanë në dispozicion me rregullat aktuale jo edhe aq të avancuara. Rinia e Kosovës do duhet të llogarit nëpërmjet vullnetarizmit, në atë se çfarë do duhet të jetë. Rini e cila nëpërmjet punëve vullnetare dhe angazhimit në vendimarrje, do të përcaktohet se çfarë meriton të jetë në të ardhmen.

Projekti nxjerr në veprim një mori njerezish në terren të veprimit, në mbajtjen e memories pozitive normale për të qenë të organizuar për çdo vitë. Projekti në fuqizimin e rinis është baza e një civilizimi me të avancuara e vleresojmë të domosdoshëm për shumë arsye njerzore. Sepse i largon të ritë nga rutina ditore e humbjes së kohës, i largon të ritë nga stresi ditorë i pa sukseshshme.

Vullnetarizmi i motivon për të ndryshuar qasjen kolektive rinisë, aktiviteti se njeriu rregullat e suksesit i bart vetë ai person, vetë ai djalë, vetë ajo vajzë, në jetën e përditshme, për fatin e tyre. Projekti i mobilizon të ritë për të qenë shembull

kombëtare, për të marrë dekorata kombëtare, për të parë vetë suksesin e punës.

Grupet e vullnetarizmit që do të krijohen në shkollë të mesme në lagje e fshatra do të zgjidhen përfaqësuesit e synuara me mandat të caktuar.

Rinia në shkollë të mesme të kërkojë drejtpërdrejt nga: Këshilli i lagjës – fshatit - qytetit, në krijimin e mundësisë të organizimit vullnetare.

Këshilli i shkollës, të rregullojë dhe të mbajë të organizuar, me zgjedhjen e përfaqësuesve të nxënësve, për organizimin e temave vullnetare.

Institucioni të ndryshojë qasjen e burimit të financimit të drejtpërdrejt, për rininë në vullnetarizëm dhe në krijimin e mundësisë së financimit në profesion të rinia.

Këto kushte të domosdoshme për një aplikim të mundësisë së re. Ndryshimin e rregullorës së financimit.

Përkrahje të drejtpërdrejt nga institucionet në ofrimin e ndihmës në zonat e banimit apo edhe në pronat individuale. Për krijimin e punës individuale, në krijimin e të hyrave familjare.

Për ndryshim qasje në burime financiare dhe informim në profesione konkrete, sipas dëshirës së vetë të riut. Të ndikojnë në fuqizimin e rinis në organizimin e punës vullnetarë, dhe organizimin në lagjë apo pronat individuale.

Rinia të organizojë në formë bashkëpunimi ndërmjet veti, inicitiva të ndryshme vullnetare që paraqiten si nevojë e domosdoshme e ndryshimit pozitiv në familje.

Një poezi për cilindo post kryetari, që nga lagja, që nga fshati, që nga qyteti, dhe culindo organizim shoqërorë.

Pozi për Kryetarë

Kryetar ishe i pa vrejtur fare.
Ishe në lagje duke u dukuri si i par.
Vendose kollare për të dalë në ballë.
Gruaja te the se e ke me orarë.
Kur pretendent për kryetar dole, krejt mahallën në rrug e nxore.
Në çarshi kur ti dole, të gjitha i more me një dorë.
Kryetarë, kolltukun kur e sigurove mundin e madhë e tregove.
Kryetar si e more ti detyrën e nxore tërë fytyrën.
Ishe gabim në të parë, sepse orari është itinerarë.
Prap gabim me të parë, me kohë të shprëndarë.
Kryetar gruaja të dha orar për të qenë i parë.
Domosdo të kërkoj të bëhet orari.
Takimin e bënë me itinerarë, kështu shokët kërkuar mundësi për orarë.
Ndryshe nuk ke orarë me të parë.
Shkon koha duke ofruar mëllëfë për orarë.
Kryetar, mbahu për orarë, mundësia të largon atë kollare.
Sepse je i parë kur të mbajsh orarë.
Kryetar kur në breg deti ti ke dal krejt bota u kthen mbarë.
Kur në deti ti ke hy, krejt detin u mundove me perpi.
Kur nga deti ti dole krejt kripen me vete ti e more.
Si e lëre këtë dëshirë, gruaja te tha ke bërë mirë.
Kryetar prej se e more në dor detyrën e nxore tërë fytyrën, kur dole si i par.
Edhe mali filloj mu tharë.

Sukseset që i kishe më paparë, të kan mbetur në sirtara, deklaroje se unë jam i parë.

Nuk kishe kohë me dalë në pazarë i zënë me punë dhe orarë.
Kryerar prap kur dole t'i në çarshi krejt populli bënë lum për ty.
Nuk të dolën me të parë, natyra dhe koha të dha pak orarë si i parë.
Shokët bënë orar dhe rrespektuan itinerar.
Por nuk munden shokët mu bër kryetar.
Prap ti mbete si i parë.
Mbajte orar, i përflakt për itinerar gjithnjë si i parë.
Me lotë poziten dhe kolltukun e lëshove, vetë ti tregove nuk kishte më kohë.
Kryetarë, nga detyra kur ti dole, edhe pluhurin me vete e more.

Frymëzimi historik, modern në familje

Mendja e frymëzuar nga pena për t'i dalë zotë vendit individit, familja me mundësinë e mundshme, të bijve dhe të bijave të kombit, që të mos harrohen, kontributi i tyre shfaqet në lëmi të ndryshme sidomos në letërsi dhe art. Vepra e njeriut unifikohet me veprimin madhor, në dekada dhe shekuj, historia në pjesën e kulturës dhe të bëmave kombëtare, si frymëzim nga veprat madhore të brezave të rinis. Është një ndër kontributet e thirrjes së kushtimit të kombit, prandaj në fushën e letërsisë dhe spikamën e artit, e shkruar nëpërmjet vargjeve për legjenda, në art veprat e kreshnikëve, mbajnë thesarë të çmuar gjatë historisë.

Rëndësia e frymëzimit nga letërsia

Veprimi i marrë nëpërmjet lëmvive në letërsi dhe arti, përbëjnë një raport si synim më i rëndësishëm është të njohësh gjuhën standarde, në cilindo moment në cilëndo kohë është e rëndësishme të shprehësh me fjalë të avancuara për kërkesën e cila është synim i një grupi apo një kombi, synim i cili përfaqësohet nga disa njerëz të cilëve u beson populli për kohë të caktuar. Letërsia në shkrimet e autorëve të cilët shprehin synimin e formësimit të historisë, nëpërmjet gjuhës, nëpërmjet vprave të larta për qëllimet e caktuara kombëtare.

Letërsia si vazhdimësi e mbajtjes së ndodhive historike, qëllim primar ka mbajtjen e memorjes kombëtare të freskët, në gjeneratat e reja si vazhdimësi e rrugës së zhvillimit të saj dhe historisë në memorjen e shoqërisë. Letërsia si degë dhe shtyllë e burimit të mendimit shoqërorë historin e përcepton në vargje, poezi, prozë, poem, monolog, dialog, romanë, gojdhena dhe fraza. Veprat e kreshnikëve, heronjëve, dëshmorëve, kontributët e larta, veprat e autorëve kombëtar të cilat shpalosin spikamen e kombit, shpalosin spikamen e tokës kombëtare, brezi i ri i nxjerrë nëpërmjet rreshtave të letërsisë.

Letërsia në fundamentin pozitiv mban një diapazon të gjërë dhe të formës me dimensione të pasura të nivelit shkencorë për ngjarje historike me pikpamje kombëtare të qasjes me argumente të verteta të fenomenit historik. Sa studiohen vargjet e rilindasve, me tregimet e tyre për heronjë dhe legjenda, të bëmat dhe sukseset e kohës, vargje të cilat zënë vendë në studime të larta akademike shkencore me rëndësi të veçantë historike. Letërsia bashkëkohore si qasje ndaj frymëzimit historik në veçanti thekson

përceptimin e ndodhis si fenomen në raport me “faktorin njeri”. Si fenomen në raport me shoqërinë se sa dominon frymëzimi për të treguar ngjarje historike në shkrime letrare, siç është me rëndësi njohja e “sistemit shoqërorë”.

Veçantia e frymëzimit historik në dialog, veçantia e frymëzimit në monolog, veçantia e frymëzimit në poezi, veçantia e frymëzimit në prozë, veçantia e frymëzimit në poemë, veçantia e frymëzimit në roman, përbëjnë një diapazon të gjërë në frymëzimin modern si interpretim historik. Kohët ndryshojnë për nga mendimi, dekadat nxjerrin në suksese figura të reja të cilat u referohen të arriturave me të larta të penës dhe kulturës kombëtare. Letërsia si degë më e pastër e njerzimit në fushën e ndryshimit të mendimit dhe emancipimit për gjeneratat të reja, në avancim dhe kualifikim të lartë të njohësve të historisë si frymëzim nacionalist.

Letërsia në dekada është atakuar me njohës dhe emra të ndryshëm të cilët mbajnë studime të cilat fokusohen rreth krijimtarisë së shkurtër. Në studime si bazë e interpretimit të autorëve paraprak, ndër studiusit e shekullit njezetë të cilët mbajnë mbi supë edhe standardizimin e gjuhës shqipe. Frymëzimi historikë i cili mbanë rëndësi të madhe në interpretimin e autorëve modern shkencor në letërsinë bashkëkohore. Modernja gjithnjë është mbështetur në rregullat klasike të shprehjes së mendimit në fushën e letërsisë si frymëzim historikë, autorët e vitëve të gjashtëdhjeta, autorët e vitëve të shtatëdhjeta janë themele të standardeve frymëzuëse në letërsinë moderne si bazë e mendimit të studimit.

Letërsia është bazë e mendimit bashkëkohorë, të cilët nxjerrin në studim dhe kalojnë mbi letërsinë moderne duke kaluar në letërsinë bashkëkohore si frymëzim historikë në interpretimin dhe bazën e mendimit.

Një metodë e frymëzimit në aspektin standardë të shprehjes bashkëkohore, si fushë e studimit dhe qasjes intelektuale të shkrimit letërarë.

“letërsia në poezi mbanë një naltësi njerzore”

“letërsia në prozë mbanë në mvetësi tregimin”

“letërsia në roman mbanë në brendi histori”

“letërsia në studime mbanë frymëzim historik”

Qasja dhe përkushtimi i formës standarde tërheqë mediumin në studime dhe frymëzim autokton, burimor duke kaluar si valë përmbi det. Qasja që nga fundamenti deri të pjedestalet e larta akademike mbahen mbi letërsinë si frymëzim publik në raport me opinionin publik, si vërtetësi studimore analitike në fushën e frymëzimit historikë të gjeneratave të reja si qasje pozitive me vështrim e analiza hulumtuëse të autoret e së ardhmës në studim.

Rëndësia e artit në frymëzim të individit dhe familjës

Arti dhe familja ka veçantinë e vetë të shprehjes së historisë, nëpërmjet pikturave të cilat shpalosin një ndjenjë të veçanet të mendimit i cili percepton të bëmat e popullit të tij. Arti ka shumë rëndësi të lart për mbajtjen e mendimit kulturës kombëtar në raport me kohën e cila ofron ndryshime në shoqërinë bashkëkohore.

Arti tregon qenjen e një kombi në periudhat e ndryshme të kohës dhe pushtetit, ndryshimin e kulturës, ndryshimin e zakonit, ndryshimin e infrastrukturës, ndryshimin e mjeteve, ndryshimin e veshjes, ndryshimin e folklorit si perceptim i kohës së re. Shoqëria mban memorje kombëtare nëpërmjet figurave të artit si dukuri që i mbijeton kohës së gjatë, sidomos mozaikët të cilët jetojnë me shekuj, artefaktet të cilat mbijetojnë me shekuj, një rëndësi e veçantë të kujtesa e gjeneratave të reja. Arti me përmbajtje historike ndryshon mendimin dhe perceptimin në ato momente kur mungon informacioni për kohë të caktuar apo për figura të ndryshme kombëtare si rendesi historike.

Monumentet si, busti, obelisku, përmendoret si pjesë e artit në portrete tregojnë gjenezën e një kombi, një kulture, një infrastrukture ndertimesh, historia i njeh këto gjëra me vlera të larta për një dimension jete. Veprat e kreshnikëve të cilët me frymëzimin për ngritjen e moralit në shoqëri shërbejnë si model i vlersimit kombëtar, kulturor të një shoqërie bashkëkohore. Pjesa pozitive e artit është gurthemel i pastër i një kulture të avancuar për gjeneratën e re. Përpunimi, rekonstruimi i artit, modifikimi, paraqitja e një figure personaliteti kombëtar nxjerrë në shikim traditën shekullore të popullit.

Arti në kohët e sotme vetëm se modifikon dhe personifikon vepren e shekujve, vepren e dekadave dhe veprimin kombëtarë, një figur arti frymëzon sa e sa trilona gojdhena, sa e sa trilona shkrime, arti bashkëkohor frymëzon qytetarin me nacionalizëm qytetar për ndjesin kombëtare. Frymëzimi nëpërmjet artit nxjerr një kulturë nacionale në shoqëri, si unifikim kombëtar.

Për të arsytuar me të bërat e patriotëve dhe mundësin e pa kursyer për jetë, arti nxjerr në shikim figurën e ndryshimit, figurën e krenarisë, figurën emocionale, figurën e legjendës, figurën e ngadhnjimit, figurën e tejkalimit të përmasave në sukses.

Ndjesia nëpërmjet frymëzimit nxitë masat në vlerësim të ndryshëm nacional të qytetaret, në munges të “faktorit njeri” për të ardhë të e verteta apo të informacionet e verteta, një apo disa figura arti pasqyrojnë vlerat e një kombi me realitet kulturor. Forca, pasuria e një populli vlerësohet në aspektin kulturor nëpërmjet artit i cili mban në vete kultur që nga lashtësia dhe periudha të cilat lënë gjurm nëpërmjet vlerës së artit, sidomos arti bashkëkohorë nxjerrë realitetin forcën e mbajtjes së gjerave autoktone burimore kombëtare. Dekadë psa dekade arti modern është transformuar në bashkëkohore në mendjen e njeriut dhe në realitet duke i dhënë një frymëzim me të avancuar mediumit dhe familjës. Ky llojë frymëzimi tërheqë shoqërinë të vlerësimi që të vlerësojë një përceptim të lartë të vlerave të një populli.

E gjithë pasuria në trashëgimi e cila i takon artit mban thesaret e pasura për gjeneratat e rinis, interpretimi i një vlere të çmuar e cila zë vendin në hierarkin me të lartë kulturore të një shoqërie intelektuale vendore dhe botërore.

“frymëzimi modern që bie mbi artin historik, për skulpturë, busti si monument historik, frymëzim me të lartë në një shoqëri bashkëkohore”.

Sipas qasjes përfundimtare për frymëzim historik si interpretim modern i historisë në letërsi dhe art. Rendësia është e shumfisht mbi ndikimin e mendjes njerzore,

letërsia dhe arti janë dy deg të shkencës të cilat mbajn vlerë të veçantë mbi frymëzimin historik si rendësi kombëtare. Arsyeja me primare e cila bënë mediumin të ushqehet me informacione konkrete, i cili mban çështjen e vertetësisë burimore në kulturë nacionale të shoqërisë.

Qendrueshmëria burimore nga arti nxjerr në jetë kulturën e lashtë me qytetari mijeravjeçare, me zakone burimore mbi bazën e kulturës tradicionale. Në fund të mendimit letërsia dhe arti jan vler në at vend që nuk ka së ndaluri pena në këto dy lëmi të pasura kulturore kombëtare.

Nga këto gjëra familja nxjerrë një vlerë të rëndësishme me identifikim kulturorë kombëtarë, rruga e pastër e kulturës familjare që kan vlere te larta të trashëgimisë kulturore, forma më e pasur e vlerave përbëhet nga ajo që është e shkruar në letër. Mendja pasurohet nga shkrimi i avancuar për lexuësin si interpretuës i një fakti për ndryshim dha avancim.

Suksese

Stafi i Shoqatës MILNKUK KOSOVA

Përgatiti shkrimin për botim.

I uron sëcilës familje, harmoni, mirëqenie, lumturi, suksese në jetë.

Kujdesi është pasuria më e çmuar në jetë.

Prishtinë: 2023